



PROCESVERBAL V/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së V (pestë) për vitin 2022 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 19.05.2022
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Nënkryetarja e Komunës znj. Mihrije Suka
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë” dhe mirënjohjen “ 13 Qershori”;**
- 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për bonus banimin;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit “Ballkani”;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës. Gjithë ashtu njofton se ka një kërkesë nga grupi parlamentar i LDK-së që të futet një pikë shtesë, e cila ka të bëjë me lirimin e taksave në aktivitet.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë.

**6 për, 1 abstenim,
Miratohet pika shtesë**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - pyet a ka vërejtje në procesverbal. Nuk ka.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë” dhe mirënjohjen “ 13 Qershori”;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - prezantove mirë procesin por nuk tregove që unë kam qenë kundër. Jo kundër individëve, jo kundër biografisë së tyre, por kam kërkuar që me shty takimin për një ditë tjetër për me analizua pak ma shumë situatën. Përveç kësaj ne si komision nuk kemi pas një rregullore paraprake që me ditë kush ka të drejtë e kush jo me apliku. Do të thotë nuk kam qenë kundër individëve por kundër procesit dhe procedurës si ka rrjedh atë ditë, sa që u detyrova me dal nga mbledhja. Ne do ta përcjellim për Asamble dhe atje e japim mendimin tonë. Procedura si ka shku nuk më ka pëlqye, por edhe reagimet e Avniut nuk më kanë pëlqye.

Avni Bytyqi - ju atë ditë keni qenë kundër individëve dhe për atë kam reaguar.

Bulëza Kuçi - ju po flisni për krejt, unë krejt nuk pi njoh. Unë e njoh vetëm Shefki Muqën. E di që asnjë fëmijë të vetin nuk e ka shkollë. Unë jam nis prej tij, por prapë nuk kam thënë që jam kundër biografisë së tyre.

Kryesuesi - në takimin që është mbajtur, unë kam menduar që do të kaloj shumë shpejt. Kanë qenë vetëm 7 propozime dhe takimi ka zgjat rreth dy orë e gjysë. Ti ke reagu për dy persona. Për Bislim Zyrapin dhe për Shefki Muqën.

Bulëza Kuçi - nuk është e vërtetë. Nuk kam reagu për Bislim Zyrapin sepse nuk e njoh, unë kam reagu vetëm për Shefki Muqën. Unë kam kërkuar kohë, të paktën një gjysmë ore me dal mi diskutuar me dikan.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit. Për ndarjen e këtyre çmimeve ekziston një rregullore dhe mbas të rregullores, besoj e keni lu rolin. Në momentin që e kemi pa në faqen zyrtare të Komunës, e kemi njoftu komunitetin,organizatat dhe unë personalisht kam bisedua me shoqatat e dala nga lufta. Unë e kam dhanë një mendim për Hysen Gegën,por ai paska marrë mirënjohje një herë. Unë i përkrasi plotësisht emrat që janë cek.

Urim Suka - e kuptoj situatën e krijuar,por kjo situatë krijohet kur ka njëri pak informacion. Rregulloren dhe emrat me biografi u kanë mirë me ja ofru komisionit,që me ditë paraprakisht kta se çka kanë me fol,dhe mu bazu nëse diçka spo funksionon me rregullore këta me than. Ne apsotutisht skemi asnjë kundërshtim me personat. Unë e di që ka qenë thirrje publike dhe secili ka pas të drejtë me bo propozime dhe besoj këto e kanë vlerën e vet dhe ne duhet mi shty përpara.Por është mirë që në secilin komision që punohet,me pas një qasje ma serioze dhe mos me ardh puna që asamblesistat me ra në lajthitje.Siq tha edhe Bulëza,ne i japim mbështetje për me shku në Asamble.

Liridon Fandaj - unë nuk kam asgjë kundër këtij vendimit,por kisha dasht që biografinë e secilit me ja dërgu secilit asamblist që me ditë kan është tu e votu. Unë e mbështes për Asamble.

Urim Suka - për Halit Elshanin, pse është refuzua kërkesa?

Kryesuesi - maksimumi i mirënjohjeve është 5,ashtu është me rregullore.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e dytë me këto propozime:Shpërblimi “Emblema e artë” ti ndahet Bislim Zyrapi nga fshati Studenqan,ndërsa Mirënjohja “13 Qershori” i ndahet Avdullah Melit Morina nga fshati Samadraxhë (postmortum),Enver M.Zeqaj nga fshati Samadraxhë (postmortum),Shefki Muqa nga Suhareka(postmortum),Afrim D.Sylaj nga fshati Sllapuzhan dhe Qazim N. Musaj nga fshati Samadraxhë.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për bonus banimin;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha - sa është vlere e qerasë? Kjo është e ndame prej kategorisë së familjeve të dëshmorëve. Për sa vite keni me dhanë?A kanë të drejtë familjet e dëshmorëve të cilët kanë përfitu ,me shit?

Nënkryetarja - ju keni qen asamblist dhe ju vet e keni votu. Bonus banimi u jepet grave të cilat janë vetushqyese,dhe u jepet 7 familjeve 40 % të qerasë e paguan Komuna. Nuk ka të bëjë me familjet e dëshmorëve.Ka qenë një vendim tre vjeçar dhe ky është viti tretë.

Liridon Fandaj - Dardani mirë e cek,që duhet me ditë vlerën.40 % po,por nuk përfitojnë barabartë.

Avni Bytyqi - është viti i tretë që u marrë vendimi nga Kuvendi,i cili subvencionon familjet që kanë nevojë për banim me 40 % të vlerës totale të banimit. Ai tutje vazhdon sqarimet si zyrtar ligjor.

Liridon Fandaj - nëse një kompani ka ndërtesa,ajo mundet mi ndryshu kontratat në faturë sado që është. Më mirë është me përcaktu një vlerë 250 euro si total .

Avni Bytyqi - zakonisht kur bëjmë thirrje dhe kur hym në procedurë të komisionit,zakonisht ne kërkojmë prej noterit. Dhe nëse ai e bjen kontratën e noterizune prej noterit dhe absolutisht smundesh mi thanë se e ki shtrejt apo lirë.Ai tutje vazhdon me sqarime.

Liridon Fandaj - unë po them me marrë një mesatare.

Urim Suka - fakti që qiraja paguhet 40 % për krejt,është një lloj barazie.

Avni Bytyqi - edhe me dasht me ja kufizu, është në kundërshtim me ligjin dhe me udhëzimin administrativ. Udhëzimi dhe ligji thotë:maksimumi është 50% e vlerës në qera të çmimit të lirë të tregut.

Urim Suka - mua më pëlqen si ide dhe mendoj që nuk duhet mu kan veq tri vjet,por me bazë ligjore është mirë me vazhdu.Është mirë me rrit numrin e familjeve sepse është e nevojshme. E dyta që dua të them është se ky vendim po miratohet në Kuvendin e Komunës dhe dikush tha që komisionin e formon Kryetari i Komunës. Kam dyshimet e mia që mundet mu përdor politikisht. Unë kisha thënë që edhe komisioni mu formu në Kuvend të komunës dhe mu kanë edhe prej partive tjera dhe paret me shku aty ku janë nevojat dhe jo aty ku janë interesat politike.

Avni Bytyqi - është viti i tretë që subvencionohen familjet dhe unë mendoj që ne asnjëherë deri më tani nuk kemi bo shkelje ligjore që janë të nxjerruna nga ky ligj. Avni Bytyqi tutje vazhdon me sqarime si zyrtar ligjor.

Urim Suka - e para,unë nuk thashë që ka pas shkelje sepse nuk di.Por nëse e di, unë e them. Unë veq ju luta që procesi me shku sa ma mirë. E dyta,përtej asaj çka kemi përgjegjësi ne,unë mendoj që edhe moralisht nëse ki nevojë është mirë me më informu, mos mem qit në lajthitje.

Dardan Berisha - më intereson të di,a ka të drejtë një familjar i dëshmorëve që ka qenë përfitues i banesës me shit. Janë komisionet e formuara prej Asamblesë që kanë me i nda asetet e Komunës. Këtë vit është dasht me u kry objekt i bonos banimit.

Liridon Fandaj - ka mundësi sepse është një ligj tjetër,që nëse i kalon 20 vjet dhe nëse noteri ia bon kontratën. Kështu që duhet me kqyr,a ka rregullore të veqantë ose a ka diçka që komuna mundet me ndalu.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime rreth pyetjes.

Urim Suka - e para , që deri 10 vjet, tepër e bukur. Mendoj që mbas 10 vjetëve le ta shet se ai do me ndrru vendbanim,dhe me atë që e shet e blen një tjetër dikun.

Liridon Fandaj - ashtu është por duhet mi mbikëqyr dhe jo me ja dhanë dikujna dhe mos me shfrytëzu dej tash dhe tash me shit.Ka familje të dëshmorëve që ende sot s'kanë dhe atij pi ja jep me shit.

Kryesuesi - deri tash Komuna iu ka nda 28 familjeve të dëshmorëve dhe gjithsej janë 90.

Avni Bytyqi - udhëzimi administrativ për bonos banimin e specifikon shumë lartë ku thotë: në momentin kur institucioni,i cili e subvencionon bonos banimin ka informata që përfituesi e ka rregullu çështjen e banimit,e ka për obligim që t'ia ndërprej bonos banimin.

Kryesuesi - rreth 60 familje të dëshmorëve janë tu prit.

Liridon Fandaj - janë dy tri banesa të familjeve të dëshmorëve,ata s'jan sepse ndoshta e kanë zgjidh banimin dikun tjetër. Por janë familje tjera që janë tu prit.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit “Ballkani”;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - a ata kanë nevojë për ndihmë,a na po dojna me ja bo dhuratë?

Kryesuesi - ata kanë nevojë pasi kanë bo dhe kërkesë.

Liridon Fandaj - kërkesa na ka ardh pasi na ka ardhë vendimi. A na ka ardh kërkesa dhe e kemi bo projekt-vebdimin apo çka?Ky vendim në bazë të neneve dhe ligjeve,nuk shkrun kërkun për subvencionim. Kërkoj sqarim ligjor. Klubi i Ballkanit shumë mirë që ka mrri,por është i privatizim dhe kapitalin fillestar e ka 50 mijë euro dhe është viti i dytë që subvencionohet. Këto janë taksa të qytetarëve dhe të buxhetit të komunës tonë,dhe ne pe subvencionojmë një SHPK.

Avni Bytyqi - është një rregullore e 2017-tës e Republikës së Kosovës për çështjen e subvencionimit të OJQ-ve,dhe është rregullorja e vitit 2013 e Kuvendit të komunës që është në fuçi e cila i përcakton kriteret dhe procedurat për çështjen e subvencionimeve edhe të personave fizikë dhe personave juridik.Është e vërtetë që rregullorja për subvencionimin thotë që Kryetari ka kompetencë ta subvencionojë deri në 5 mijë euro një person juridik,por është një pasus më poshtë dhe thotë: nëse kërkesa e tejkalon vlerën për të cilën e ka kompetencë Kryetari i Komunës të jep vlerën,atëherë kjo kërkesë i adresohet KPF-së,nëse këtë kompetencë dhe këtë mandat ja ka bartë Kuvnedi i komunës.Në këtë rast,as mandatin e kalum as këtë mandat Kuvendi i Komunës këtë të drejtë nuk ja ka bartë KPF-së,por këtë të drejtë ia ka lënë vetit.

Liridon Fandaj - pika e dytë e këtij projekt-vendimi 1.2 është:mjetet lëshohen nga kategoria e subvencioneve,dhe asnjërin prej këtyre ligjeve nuk e kam gjet. Rregullorja e Ministrisë së Financave e vitit 2017 thotë që kanë ka drejt me subvencion dhe janë OJQ-të por jo kompanitë private.

Urim Suka - Ballkanit duhet me ja dhanë 200 mijë. Vetëm le ta sqaron bazën ligjore, se a kemi të drejtë apo jo.

Avni Bytyqi - për subvencionimin e aktiviteteve të OJQ-ve e kemi rregulloren e e qeverisë së Republikës së Kosovës dhe për çështjen e subvencionimit të personave fizikë, individëve dhe personave juridikë e kemi këtë rregullore. Si zyrtar ligjor lexon rregulloren dhe jep sqarime.

Liridon Fandaj - unë jam për klubin e Ballkanit, por nese subvencionohet me 80 mijë euro duhet me rregullu diçka në stadium dhe jo me pagu bileta ose shpenzime operationale.

Dardan Berisha - përveq datës që tha Liridoni, në bazë të kalkulimeve që i kam bo në bazë të kërkesës që e kanë bo këta, mua më dalin 81 mijë euro shpenzime. Duhet mu krenu me Ballkanin por ne e kemi edhe Yllin edhe klube tjera. Me stadiumin u abuzu shumë prej se u zu tenderi për ndërtimin e ulësëve dhe ende nuk ka ulësë. Vitin e kalim ja kemi dhënë 88 mijë euro, dhe me ato pare ka shku në Turqi, dhe prap ka ardh me kërkesën e njejtë. Edhe pse ne nuk jemi kundër.

Urim Suka - kjo qka po folim është prap e njëjta qasje që ju e keni dhe është qasje tipike gabim me fillim. Unë jam për me ja dhanë 200 mijë por jo në këtë formë. Nuk mundesh me ja dhanë 80 mijë një klubi dhe 0 klubeve tjera. Unë dua ti mbroj taksat e qytetarëve. Unë them, ta bëjmë një rregullore që i subvencionon të gjithë njësoj.

Sanie Kuçi Rexhepaj - çka dashta me thanë, pak a shumë e përmbledh atë çka tha Liridoni dhe atë çka tha Urimi, por mendoj që me subvencionime duhet me shku në mënyrë proporcionale. Kemi edhe një ekip tjetër që është gati mu shpall kampion, kemi edhe ekipe të tjera që ndoshta nuk janë tu u shpall kampion por e meritojnë subvencionimin për me i inspiruar. Tu e marrë parasysh që edhe e kemi subvencionu vitin e kaluar me 80 mijë euro, ia kemi dhënë stadiumin në shfrytëzim, dhe mendoj që kemi bo mjaftueshëm që me ardh prap në këtë pikë dhe me ja dhanë 80 mijë euro të tjera. Jemi në situatë të rëndë ekonomike, janë tu u rrit çmimet, po rritet varfëria, dhe mendoj që është e tepërt kërkesa e Cima construction. Ndoshta e përkrahi Urimin, që thotë që duhet me bo një rregullore që të gjitha klubet qofshin OJQ ose SHPK me u subvencionu në mënyrë proporcionale.

Dardan Berisha - nëse klubi është në krizë ekonomike, është e vërtetë që duhet mi ndihmu, por ne si komunë nuk kemi të drejtë, skami qasje. Por ai, nëse ka krizë ekonomike, ne ti shet aksionet. 80 mijë euro mu hargju për një javë është shumë.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**4 për ,2 kundër, 1 apstenim
Miratohet**

Pika shtesë - lirimi i taksave në aktivitet;

Kryesuesi - pika shtesë është kërkesë e LDK-së, e cila po kërkon ta përcjellim për Asamble. Taksa në aktivitet mua nuk më duket shumë e madhe. Sa kam informacione taksa në aktivitet sjell rreth 200 mijë euro të hyra në komunën tonë. Unë nuk e shoh të arsyeshme me hek këtë taks. Hap debatin.

Dardan Berisha - a kanë krizë bizneset, pse me i liru? Në kohën e pandemisë ne i kemi liru për 6 muaj bizneset. Janë të hyra që varen prej bizneseve dhe nuk më duket e arsyeshme.

Urim Suka - nga kjo taksë mblidhen rreth 200 mijë euro dhe për Komunën nuk janë shumë. Sidomos bizneset e vogla e kanë impaktin ma të madhë dhe disa biznese që janë ma të mëdhaja doken qesharak. Por ne i kemi përfshi të gjitha bizneset. Një numër i madh i komunave e kanë zero taksën në aktivitet. Në planin tonë si LDK e kemi pas që nëse vim në pushtet me lan zero, dhe karshi asaj po mundohemi me shty edhe në Asamble, duke e llogaritur që disa biznese kohëve të fundit kanë humbje. Mendoj që duhet me mbështet të gjithë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - sa ndikohet buxheti i komunës në këtë rast, sa biznese ka dhe sa merr të hyra nga taksa në aktivitet.

Kryesuesi - rreth 200 mijë euro në vit.

Dardan Berisha - gjatë gjithë fjalimit po përmenden bizneset e vogla, a është mundësia që ky projekt-vendim të orientohet te bizneset e vogla?

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime.

Liridon Fandaj - 200 mijë janë të parashikuara. Këta kanë shumë biznese që sot ju vin me gjendje të ATK-së ,që janë me gjendje pasive. Unë pajtohem se duhet me pas ni pasqyrë dhe me pa sa është implikimi. Mbështes idenë për mi ju hek taksat komunale dhe duhet me cek afatin kohor.

Urim Suka - ideja ka qenë për me zan Kornizën afatmesme buxhetore.

Avni Bytyqi - ideja për me liru prej taksës në aktivitet ka qenë projekt i USAID-it nga viti 2012 për të gjitha komunat.Me anë të rregullores që është në 2015 e miratune,bizneset e reja,sidomos bizneset e prodhimeve bujqësore janë të liruara 3 vjet prej taksës.

Labinot Halitjaha - puna e taksës komunale ka një dallim me tatimin. Tatimi paguhet prej shtetit dhe nuk ka nevojë për destinim. Në momentin që ja merr dikuj taksën ,duhet mu destinu për atë kategori.

Urim Suka - mujn me qenë mjete tjera që përdoren për me hap ni zonë industriale dikun.

Labinot Halitjaha - bizneset e vogla,ne e kemi një rregullore që kohën që s'kan punu ,mujn me apliku dhe ne me ja zbrit taksën me zero.

Avni Bytyqi - analizone mirë,sepse bankat,posta pompat i lironi ka 3000,1500 e 2000 euro.

Labinot Halitjaha - për mendimin tim është mirë me bo ni destinim të parasë,me shku për biznese dhe jo paret e bizneseve me shku subvencion.

Kryesuesi - unë nuk jam për me e dërgu në Asamble që me hek taksën në aktivitet.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë.

3 për,3 kundër,1 abstenim

Kryesuesi e shfrytëzon të drejtën e votës së dyfishtë dhe kjo pikë shtesë nuk kalon për në Asamble.

Takimi përfundoi: **14:30**

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj